



Landeslease SH.A.

Nr. Prot

1322.

Tirane me 30.07.2013

Drejtuar : Drejtorise Rajonale te Tatimpaguesve te Medhenj
Rruga Presidenti George W. Bush
Tirane

Lenda: **Dorezim i Pasqyrave Financiare per vitin 2012**

LANDESLEASE Sha

K51629002M

Ju lutem, gjeni bashkengjitur Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur 2012, te shoqerise Landeslease sha. me NIPT K51629002M, te cilat **ne baze te Udhezimit nr.4107 dt.22.2.2012** jane shoqeruara me anekset dhe dokumentacionin si me poshte vijon:

Pasqyrat Financiare me 31.12.2012 (1 kopje),

Shenimet Shpjeguese per Pasqyrat Financiare 31.12.2012 (1 kopje),

Formularet Sipas Tatimeve.

Opinion i Expertit Kontabel dhe Auditorit te shoqerise (1 kopje),

Deklarata e Administratorit per aksioneret dhe hartuesin e pasqyrave financiare,

Kontrata e qerase per ambjentet me qera,

Pasqyra e Aktiveve Afatgjata materiale ,

Inventari i mjeteve te trasnportit ne pronesi,

Formulari i Deklarimit Vjetor te Tatimit mbi Fitimin per periudhen 2012 me kopje te urdherxhirimit per pagesen,

Vertetim pagesa e taksave vjetore vendore per vitin 2012,

Vendimi i Asambles per fitimin e vitit 2012.

Gjithashtu nje kopje ne CD e Pasqyrave Financiare dhe Shenimeve Shpjeguese.

Me Respekt

Altin Saliasi

Drejtor Ekzekutiv



Landeslease Sh.A.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**


Përmbajtje

Raporti i audituesit të pavarur	1
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	1
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese	5

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIME

Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(te gjithë shumat janë në LEK)	Shënime	31 dhjetor	
		2012	2011 riparaqitur
Të ardhurat nga interesat	5	216,890,112	172,521,726
Shpenzime për interesa	6	(96,585,276)	(79,582,929)
Të ardhura neto nga interesat		120,304,836	92,938,797
Të ardhurat neto nga komisionet	7	7,852,967	9,706,089
Fitimi bruto nga aktiviteti		128,157,803	102,644,886
Shpenzime administrative	8	(25,971,639)	(27,631,349)
Shpenzime per punonjesit	9	(26,854,772)	(26,866,731)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	16,17	(2,078,882)	(2,391,465)
Shpenzime operative		(54,905,243)	(56,889,545)
Shpenzime të tjera	10	(2,107,281)	(15,484,439)
Zhvlerësimi i qirave financiare	14	(20,236,748)	(8,501,883)
Fitimi nga kurset e këmbimit	11	4,940,688	275,986
Fitimi para tatimit		55,849,218	22,045,005
Tatimi mbi fitimin	12,18	(5,629,086)	(3,930,677)
Fitimi për vitin		50,220,132	18,114,328
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		50,220,132	18,114,328




BILANCI

Më 31 dhjetor 2012

		31 dhjetor	
(të gjithë shumat janë në LEK)	Shënime	2012	2011 riparaqitur
AKTIVET			
Mjete monetare	13	196,980,900	57,797,676
Qira financiare e arkëtueshme	14	1,425,689,099	1,498,134,472
Llogari të tjera të arkëtueshme	15	7,866,952	13,179,383
Aktive afatgjata jomateriale	16	5,295,302	6,235,553
Aktive afatgjata materiale	17	3,907,868	5,093,998
Të drejta tatimore të shtyra	18	3,949,079	2,159,091
Aktiva të tjera	19	121,035,338	190,092,240
TOTALI I AKTIVIT		1,764,724,539	1,772,692,413
DETYRIMET			
Kredi dhe hua të tjera	20	1,302,110,201	1,427,825,911
Detyrime ndaj furnitorëve dhe klientëve	21	32,709,096	34,234,562
Tatim-fitimi i pagueshëm		1,821,394	-
Detyrime të tjera	22	39,141	1,957,365
Totali i detyrimeve		1,336,679,831	1,464,017,838
KAPITALI			
Kapitali aksioner	23	308,988,000	239,838,000
Primi i aksioneve		62,019,320	62,019,320
Humbje të mbartura		6,817,255	(11,297,073)
Fitimi i vitit		50,220,132	18,114,328
Totali i kapitalit dhe rezervat		428,044,708	308,674,575
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,764,724,539	1,772,692,413

Pasqyrat financiare në faqet 1-42 u miratuan nga Bordi Drejtues më 17 maj 2013:

Altin Saliasi
Drejtor Ekzekutiv

Luljeta Rodoni
Menaxher e Financës



Landeslease Sh.a.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

Me 31 dhjetor 2012

<i>(të gjithë shumat janë në LEK)</i>	Kapitali Aksioner	Primi Aksioneve	(Humbja e akumuluar) / Fitimi i mbartur	Totali
Më 1 janar 2011				
Fitimi për vitin	239,838,000	62,019,320	(11,297,073)	290,560,247
	-	-	18,114,328	32,768,130
Më 31 dhjetor 2011	239,838,000	62,019,320	6,817,255	308,674,575
Më 1 janar 2012	239,838,000	62,019,320	6,817,255	308,674,575
Fitimi për vitin	-	-	50,220,132	50,220,132
Nëshkrimi i aksioneve të reja	69,150,000	-	-	69,150,000
Më 31 dhjetor 2012	308,988,000	62,019,320	57,037,387	428,044,707



PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE
Më 31 dhjetor 2012

<i>(te gjithë shumat jane ne LEK)</i>	Shënime	Viti I mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti I mbyllur më 31 dhjetor 2011 riparaqitur
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi (Humbja) para tatimit		50,157,200	22,045,006
Rregullime për:			
Ndryshimi në zhvlerësimin e qirasë financiare	14	20,236,748	10,632,665
Amortizimi		2,078,882	2,391,465
Çrregjistrime të qirasë financiare të arkëtueshme	16,17	1,252,437	16,301,415
Shpenzime për interesa	6	96,585,276	79,582,929
Të ardhura nga interesat	5	(216,890,112)	(172,521,726)
Kompensime tatimore		(3,255,612)	-
Të tjera		(1,574)	(275,986)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative		(44,144,737)	(41,844,232)
 Rënie/(Rritje) në qiranë financiare të arkëtueshme		50,956,188	(419,928,953)
Rënie në llogaritë e tjera të arkëtueshme		5,312,431	7,206,964
Rënie/(Rritje) në aktive të tjera		69,056,902	(62,749,638)
(Rënie)/Rritje në detyrime nga klientë dhe furnitorë		(1,525,466)	11,565,506
(Rënie)/Rritje në detyrime të tjera		(1,918,224)	246,198
Paraja e përdorur për aktivitetet operative		121,881,831	(463,659,923)
Interes i arkëtuar		216,890,112	153,840,847
Interes i paguar		(90,049,089)	(71,130,039)
Tatim-fitimi i paguar		(2,341,716)	(2,272,185)
Paraja neto e përdorur për aktivitetet operative		202,218,762	(425,065,532)
 Flukset e parasë në aktivitetet e investimit			
Shitje e aktiveve materiale		972,185	-
Blerje e aktiveve materiale dhe jo materiale	16,17	(923,465)	(1,324,886)
Paraja neto e përdorur për aktivitetet e investimit		48,720	(1,324,886)
 Flukset e parave nga aktivitetet e financimit			
Fonde të marra hua		299,559,500	647,645,179
Kredi bankare të paguara		(431,811,397)	(302,324,878)
Nënshkrimi i aksioneve të reja		69,150,000	-
Fluksi neto i gjeneruar nga aktivitetet e financimit		(63,101,897)	345,320,301
 Rritja (rënia) neto e mjeteve monetare		139,183,224	(81,070,117)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		57,797,676	138,867,793
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	13	196,980,900	57,797,676



SHËNIMI 1 – TË PËRGJITHSHME

Landeslease sh.a. ("Kompania") e regjistruar si shoqëri anonime më 27 mars 2005 në Shqipëri sipas ligjeve në fuqi me vendimin e gjykatës nr. 33307 dhe NIPT K51629002M. Kompania e ka filluar aktivitetin e saj më 5 prill 2005.

Kapitali i regjistruar dhe i paguar i Kompanisë është përafërsisht 2.9 mln euro (405 mln LEK) duke përfshirë edhe primin e aksioneve.

Struktura e aksionerëve dhe e drejtimit më 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	Numri Aksioneve	%
Emerging Europe Leasing and Finance (EELF) B.V	222,258	71.93%
Hysen Ruka	73,733	23.86%
Altin Saliasi	11,302	3.66%
Stephen Strauss	1,695	0.55%
	308,988	100.00%

Emerging Europe Leasing and Finance (EELF) B.V është një fond privat investimesh i vendosur në Hollandë dhe i kontrolluar 75% nga Fondi i Ballkanit (BAF) dhe 25% nga Deutsche Investitions –Und Entwicklungsgesellschaft MBH ('DEG').

Aksionerët kryesorë të BAF janë: Fondi Rumun-Amerikan i Zhvillimit, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe institucionet financiare FMO(Hollande), DEG (Gjermani) dhe Banka për Zhvillim dhe Tregti e Detit të Zi.

Aktiviteti kryesor i Kompanisë

Dhënie me qira financiare të makinerive, pajisjeve të prodhimit, makinerive të lehta dhe të rënda, makinerive të specializuara për transport, real estate etj.

Adresa zyrtare e Kompanisë

Adresa zyrtare e kompanisë është Rr. Themistokli Gërmenj, nr. 10 , Tiranë, Shqipëri.

Bordi Mbikqyres

Z. Neculai Sandu
Znj. Adriana Campeanu
Z. Stephen Strauss

Bordi Drejtues

Z. Altin Saliasi – Drejtor i Përgjithshëm
Znj.Valbona Gaxha – Manexhere e Financës dhe Kontabilitetit, deri më 31 dhjetor 2012
Znj.Luljeta Rodoni – Menaxhere e Financës dhe Kontabilitetit, duke filluar nga 1 janar 2013
Z. Dorin Maraku – Menaxher i Riskut, Anëtar

Monedha prezantuese

Monedha prezantuese e kompanisë është Euro.



SHËNIMI 1 – TË PËRGJITHSHME (Vazhdim)

Përgjegjësia e drejtimit për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bordi drejtues i Kompanisë duhet të përgatisë pasqyrat financiare për çdo vit financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat japin një pamje të drejtë e të besueshme të pozicionit financiar të Kompanisë dhe të rezultatit të aktivitetit, të ndryshmeve në kapital dhe flukseve monetare për periudhën raportuese.

Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Duke patur parasysh faktin që një pjesë e huave të Kompanisë më 31 dhjetor 2012, mund të ishin të pagueshme në të parë kundrejt huadhënësit përkatës në vijim të shkeljes së njërit prej kriterëve (siç është përshkruar në shënimin 20). Kompania pas disa negociatash, ka marrë një dokument çlirues nga huadhënësi më 1 korrik 2013, që mbulon periudhën shtator 2012 – shtator 2013. Rrjedhimisht, drejtuesit kanë një pritshmëri të arsyeshme që Kompania zotëron burimet e nevojshme për të vijuar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Në këtë mënyrë është e përshtatshme përgatitja e pasqyrave në bazë të parimit të vijimësisë. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të ishin rezultat i pamundësisë së Kompanisë për të kryer veprimtarinë e saj në vijimësi.

Bordit Drejtues i kërkohet që:

- të zgjedhë politika kontabël të përshtatshme dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe ti zbatojë ato në mënyrë konsistente (shënimi 4);
- të bëjë gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe korrekte;
- të zbatojë standarde kontabël efektive;
- të përgatisë pasqyrat financiare mbi parimin e vijimësisë.

Bordi Drejtues është përgjegjës për mbajtjen e rregullt të kontabilitetit, të cilat paraqesin me korrektesi e saktësi në çdo moment pozicionin financiar të Kompanisë dhe përputhshmërinë e tyre me SNRF.

Bordi Drejtues është gjithashtu përgjegjës për të mbrojtur pasurinë e Kompanisë dhe të marrë masa të arsyeshme për të parandaluar çdo parregullsi dhe shpërdorim.

SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Parimet Kontabël të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura si më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

2.1 Baza e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuarë Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar nën konventën e kostos historike.

Këto pasqyra janë përgatitur bazuar në ato standarte dhe interpretime që kanë qënë efektive për periudhën të cilës i përketin këto pasqyra.

Adaptimi i standardeve të reja apo të rishikuara dhe prononcimeve të reja kontabël

(i) Standarde të reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Kompania



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.1 Baza e Përgatitjes (vazhdim)

Nuk ka SNRF apo interpretime të reja të KIRFN të cilat hyjnë në fuqi për herë të parë më ose pas datës 1 janar 2012 dhe që kanë një ndikim të rëndësishëm ndaj Kompanisë.

(ii) Disa standarde dhe interpretime të reja të publikuara të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013 të cilat shoqëria nuk i ka adoptuar më herët


SNRF 9, Instrumentet financiare: klasifikimi dhe matja. Ky standard, i publikuar në nëntor të vitit 2009, zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që lidhen me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. SNRF 9 u ndryshua më tej në tetor 2010 për të përcaktuar klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në dhjetor 2011 (i) për të ndryshuar datën efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2015 dhe (ii) për të përfshirë shënime shpjeguese për periudhën kalimtare. Karakteristikat kryesore të standardit janë si më poshtë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në dy kategori matje: në aktive financiare të cilat do të matën në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë, dhe ato të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar. Vendimi duhet të merret në momentin e njohjes fillestare të aktivitetit. Klasifikimi varet nga modeli që njësia ekonomike ndjek për menaxhimin e aktiveve të veta financiare dhe karakteristikat e flukseve monetare të instrumentit.
- Një instrument matet në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar vetëm nëse është një instrument borxhi dhe dy kushtet në vijim plotësohen njëkohësisht: (i) objektivi i njësisë ekonomike është të mbajë aktivin për të mbledhur/përfutur flukset monetare kontraktuale, dhe (ii) flukset monetare kontraktuale të aktivitetit përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesi (që do të thotë që instrumenti ka vetëm "karakteristikat bazë të huasë"). Të gjithë instrumentet e tjerë të borxhit duhet të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit duhet të vlerësohen në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të cilat mbahen për tregtim do të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Ndërkohë, për gjithë instrumentet e tjerë të kapitalit, në momentin e njohjes fillestare mund të bëhet një zgjedhje e pakthyeshme për të njohur fitimet dhe humbjet kapitale të realizuara dhe të parealizuara përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo përmes fitimit ose humbjes. Fitimet ose humbjet nga vlera e drejtë nuk do të kalojnë më përmes fitimit ose humbjes. Kjo zgjedhje mund të bëhet veçmas për çdo instrument. Dividendët duhet të prezantohen në fitim ose humbje, për sa kohë që përfaqësojnë kthime nga investimi.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë transferuar pa ndryshime tek SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se njësia ekonomike tashmë i kërket të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Zbatimi i SNRF 9 është i detyrueshëm prej datës 1 janar 2015, zbatim më i hershëm është i lejueshëm.

SNRF 13, "Matja e vlerës së drejtë" (publikuar në maj të vitit 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013), ka për qëllim të përmirësojë konsistencën dhe të reduktojë kompleksitetin duke ofruar një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, një burim të vetëm për matjen e vlerës së drejtë, si dhe kërkesat për dhënien e shënimeve shpjeguese për përdorim nga gjithë SNRF-të.

Ndryshimet në SNK 1, "Paraqitja e pasqyrave financiare" (publikuar në qershor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2012) ndryshojnë mënyrën e paraqitjes e shënimeve shpjeguese të zërave të përfshira në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë që njësia ekonomike të paraqesë zërat e paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në dy grupe, në varësi të faktit nëse ekziston mundësia e ri-klasifikimit të tyre në fitim ose humbje në të ardhmen.



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.1 Baza e Përgatitjes (vazhdim)

Emërtimi i sugjeruar nga SNK 1 është ndryshuar në “pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse”. shoqëria pret që standardi i ndryshuar të ndikojë në paraqitjen e pasqyrave të saj financiare, por duke mos ndikuar në matjen e transaksioneve dhe balancave.

Ndryshime në SNRF 7, “Shënimet shpjeguese – Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare” (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013). Ndryshimet kërkojnë dhënie të shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare të cilat mundësojnë vlerësim të efektit apo efektin e mundshëm të marrëveshjeve të kompensimit nga lexuesi i pasqyrave, duke përfshirë edhe të drejtat për kompensim.

Ndryshime në SNK 32, “Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare” (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose më pas datës 1 janar 2014). Ndryshimet kanë sjellë udhëzime shtesë për zbatimin e SNK 32 për të mënjeluar mungesën e konsistencës lidhur me zbatimin e disa prej kriterëve të kompensimit, duke përfshirë sqarimin e kuptimit të shprehjes “e drejtë ligjore e detyrueshme për të kompensuar” dhe disa sisteme të kompensimit në baza bruto që mund të konsiderohen ekuivalente me ato të kompensimit neto.

Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (publikuar në maj 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013). Përmirësimet konsistojnë në ndryshime të pesë standardeve. SNRF 1 u ndryshua (i) për të qartësuar se një njësi ekonomike që rinis të përgatisë pasqyrat e saj financiare SNRF mund të ri-aplikojë SNRF 1 ose të aplikojë të gjitha SNRF-të retrospektivisht sikur të mos kishte ndaluar ndonjëherë së aplikuari ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga aplikimi retrospektiv i SNK 23 “Kosto të huamarrjes” nga zbatuesit për herë të parë të SNRF-ve. SNK1 u ndryshua për të qartësuar se shënimet shpjeguese nuk nevojiten për të mbështetur pasqyrën e paraqitur për periudhën e tretë krahasuese e cila kërkohet të ri-paraqitet për shkak retrospektivitet ndikimit të rëndësishëm të ri-paraqitjes retrospektive, ndryshime në politikat kontabël apo ri-klasifikime për qëllime të paraqitjes, ndërkohë që dhënia e shënimeve shpjeguese do të jetë e nevojshme vetëm nëse shoqëria vendos që të ofrojë pasqyra krahasuese shtesë vullnetarisht. SNK 16 u ndryshua për të qartësuar se pajisjet e shërbimit të cilat do të përdoren për më shumë se një periudhë do të klasifikohen si aktive afatgjata materiale dhe jo si inventar. SNK 32 u ndryshua për të qartësuar se pasojat fiskale të shpërndarjeve ndaj aksionarëve duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave, siç janë kërkuar gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të mundësuar përputhjen e kërkesave të saj me ato të SNRF 8.

SNK 34 do të kërkojë dhënie të shënimeve shpjeguese për një tregues të matjes së totalit të aktiveve dhe pasiveve për një segment operativ të caktuar, vetëm nëse ky informacion i jepet rregullisht vendimmarrësit të aktivitetit operativ dhe ka patur një ndryshim të rëndësishëm në këto tregues nga pasqyrat financiare të vitit të kaluar.

Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara të cilat nuk janë të rëndësishme për shoqërinë:

SNRF 10, “Pasqyrat financiare të konsoliduara”

SNRF 11, “Marrëveshjet e përbashkëta”

SNRF 12, “Shënimet shpjeguese mbi interesat në njësi të tjera ekonomike”

SNK 27, “Pasqyrat financiare individuale”

SNK 28, “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta”

SNRF 1, “Zbatimi i SNRF-ve për herë të parë – Huatë qeveritare”

SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – “Njësite ekonomike investuese”

KIRFN 20, “Shpenzimet e heqjes në procesin e prodhimit të një sipërfaqeje minerare



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.1 Baza e Përgatitjes (vazhdim)

Standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë, nëse më sipër nuk është përmendur ndryshe.

Parimet bazë të kontabilitetit të aplikuara gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave përshkruhen më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe në periudhat e mëparshme, përveç rasteve kur përmendet ndryshe.

2.2 Monedha Raportuese

(a) Monedha funksionale dhe raportuese

Shumat e përfshira në pasqyrat financiare të Kompanisë janë vlerësuar bazuar mbi mjedisin primar ekonomik në të cilin vepron njësi - LEK ("monedha funksionale"), e cila është monedha funksionale. Pasqyrat financiare të shoqërisë paraqiten në Euro ("EUR"), që përfaqëson monedhën e prezantimit të Kompanisë. Arsyeja e përdorimit të një monedhe prezantimi ndryshe nga ajo funksionale lidhet me qëllimin për të përmbushur pritshmëritë e aksionerëve ekzistues, financuesëve potencial si dhe huadhënësëve. Këto pasqyra janë paraqitur në monedhën funksionale.

(b) Transaksionet dhe tepricat e llogarive në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit të datës përkatëse të transaksionit. Aktivët dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e ndërtimit të bilancit kontabël janë përkthyer në Lek duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date. Fitimet dhe humbjet e rezultuara nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare dhe nga transaksionet e këmbimit janë njohur dhe janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

(c) Transaksionet dhe tepricat e llogarive në monedhën prezantuese

Të gjitha aktivët dhe detyrimet janë përkthyer nga monedha prezantuese me kursin e këmbimit të datës së pasqyrës së pozicionit financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për të gjitha periudhat janë përkthyer duke përdorur kursin mesatar të periudhës.

Kapitali, humbja e akumuluar dhe rezervat e tjera janë përkthyer me kurset historike të datës së transaksionit. Si përfundim, të gjitha diferencat nga përkthimi i monedhës njihen si të ardhura të tjera.

(d) Kurset e këmbimit me monedhat e huaja

Më 31 dhjetor 2012 aktivët monetare, detyrimet monetare janë konvertuar dhe paraqitur me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë: EURO/LEK 139.59 (31 dhjetor 2011: 138.93) dhe kursi mesatar i përdorur për të konvertuar zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve: EURO/LEK 139.33 (2011: 140.64).

2.3 Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët afatgjatë materiale si pronat, tokat dhe paisjet janë paraqitur në bilancin kontabël me koston historike neto minus zhvlerësimin e akumuluar. Kosto historike përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë marrjes së aktivitetit. Kostot shtesë të aktiveve përfshihen në vlerën e mbartur të aktiveve ose njihen si një aktiv më vete vetëm në rast se është e mundur që në të ardhmen përfitime të lidhura me aktivin do të hyjnë në kompani dhe në qoftë se kostoja e aktivitetit mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e pjesëve të aktivitetit të zëvendësuar ç'regjistrohet



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)**2.3 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)**

nga kontabiliteti. Të gjitha shpenzimet e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes përfshihen në pasqyrën e të ardhurave të periudhës kur ato kryhen.

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i aktiveve të tjera është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të shpërndarë koston e aktivitetit gjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Zhvlerësimi llogaritet për secilin aktiv deri deri sa kostoja e tij të zhvlerësohet plotësisht ose deri në vlerën e tij të mbetur nëse ajo është materiale.

Përqindjet e zhvlerësimit vjetor bazuar në jetën e dobishme të aktiveve janë si vijon:

Përshkrimi:	Jetëgjatësia në vite:
Mjete Motorrike	4
Paisje zyre	4
Mobilje	5
Kompjuterë	4

Vlera dhe jeta e mbetur e aktiveve rishikohen në çdo datë ndërtimi të bilancit kontabël pasqyrohet nëse ndryshimi është material. Vlera e mbetur e aktivitetit zvogëlohet deri në vlerën e tij të realizueshme në rast se vlera mbetur tejkalon vlerën e realizueshme. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen nga krahasimi i vlerës së realizuar dhe koston historike dhe përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Aktivet Afatgjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale përfshijnë liqensat e software-ve. Liqensat e software-ve kompjuterike janë kapitalizuar në bazë të kostove dhe shpenzimeve të ndodhura, të nevojshme për marrjen dhe vënien në përdorim të software-it përkatës specifik. Kostoja e tyre amortizohet përgjatë jetës së tyre të dobishme të llogaritur shtatë vjet e cila reflekton periudhën gjatë së cilës Kompania do të ketë përfitime nga software i ri i quajtur Charisma.

2.5 Aktive afatgjata që mbahen për tu shitur

Aktivitet afatgjata klasifikohen si aktive për tu shitur kur vlera e tyre do të rikuperohet nga transaksioni i shitjes dhe transaksioni i shitjes do të ndodhi. Aktivitet mbahen me vlerën më të vogël midis vlerës kontabël dhe vlerës reale duke zbritur kostot e shitjes.

2.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Aktivitet të cilat janë subjekt i zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen në lidhje me rënien e vlerës sa herë që ngjarje dhe ndryshime të rrethanave tregojnë që vlera e mbartur mund të mos rikuperohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet për shumën që vlera e mbartur tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë të aktivitetit pakësuar me kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivitetit. Për vlerësimin e masës së zhvlerësimit, aktivitet grupohen në njësi gjenerike më të vogla, flukset monetare të të cilave janë lehtësisht të identifikueshme. Aktivitet jo financiare të cilat kanë pësuar një rënie në vlerë rishikohen në çdo datë raportimi për ndonjë rritje të mundshme të vlerës.



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.7 Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe nuk janë të listuara (kuotuar) në një treg aktiv. Ato janë përfshirë në aktivet rrjedhëse (afat-shkurtra) përveç huave dhe të arkëtueshmeve me afat maturimi më të madh se 12 muaj nga data e bilancit, të cilat janë klasifikuar si aktive jo-rrjedhëse(afat-gjata).

Kompania vlerëson në çdo date bilanci nëse ekziston një evidence objektive që një aktiv apo një grup aktivesh financiare ka pësuar rënie në vlerë.

2.8 Qiraja financiare

Kur Kompania është Qiradhënësi

Një qira përkufizohet si një marrëveshje midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, ku qiradhënësi jep me qira një aktiv dhe të drejtën e përdorimit të tij për një periudhë të përcaktuar kohe, në këmbim të një pagese ose të një serie pagesash nga ana e qiramarrësit. Një qira mund të klasifikohet si qira operative ose si qira financiare.

Qirate financiare janë qira ku risqet dhe përfitimet që lidhen me përdorimin dhe pronësinë e aktivit transferohen në mënyrë thelbësore nga qiradhënësi tek qiramarrësi. Titulli ligjor i pronësisë mund të transferohet ose jo. Qira operative janë të gjitha qiratë, përveç atyre financiare.

Në rastin e qirasë financiare Kompania njihet në bilancin e saj kontabël aktivin e dhënë me qira financiare si një të drejtë të arkëtueshme të barabartë me vlerën e investimit neto në qira financiare. Vlera e investimit neto në qira financiare është investimi bruto në qira financiare i skontuar me normën e interesit të përfshirë në kontratën e qirasë. Norma e interesit e përfshirë në kontratën e qirasë, është norma e skontimit e cila në fillim të afatit të qirasë barazon totalin e vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë dhe vlerës së mbetur të pagarrantuar me shumën e vlerës së drejtë dhe kostove që lidhen në mënyrë direkte me aktivin e dhënë me qira nga qiradhënësi. Diferenca ndërmjet vlerës bruto të të arkëtueshmeve dhe vlerës së tyre aktuale përbën të ardhurën financiare të pa përfituar.

Të adhurat nga qiraja financiare njihen përgjatë periudhës së qirasë sipas një baze sistematike duke përdorur metodën e investimit neto, e cila reflekton normën konstante periodike të kthimit në investimin neto të qiradhënësit.

Kur Kompania është Qiramarrësi

Kompania jep me qira aktive të trupëzuara të caktuara. Qiratë në të cilat jepen me qira aktive fikse të trupëzuara ku Kompania mban të gjitha risqet dhe përfitimet thelbësore që lidhen me pronësinë e aktivit dhe ku Kompania është në pozicionin e qiramarrësit, klasifikohen si qira financiare.

Qiratë në të cilat një sasi konsiderueshme e risqeve dhe përfitimeve që lidhen me pronësinë e aktivit të dhënë me qira nuk mbahen nga qiradhënësi, klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra në qiratë operative përfshihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë periudhës së qirasë.



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.9 Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe të arkëtueshmeve nga qirrate financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet qe është zhvlerësuar nese evidenca objektive tregojne qe nje ose me shume ngjarje kane patur ndikim negativ ne fluset e ardhme te perlogaritura te ketij aktivi.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar i cili matet me koston e amortizuar, matet si diferenca ndërmjet vlerës së tij të mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivet financiare të veçanta testohen në lidhje me rënien në vlerë mbi bazë individuale. Aktivet financiare që mbeten vlerësohen kolektivisht në grupe që kanë karakteristika të përbashkëta të riskut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitimet dhe humbjet e periudhës kur ndodh zhvlerësimi. Një humbje nga zhvlerësimi mund të rimerret nëse përcaktohet në mënyrë objektive një ngjarje e ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në fitimet dhe humbjet.

Një provision për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve krijohet atëherë kur ekziston një evidencë objektive që kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e përcaktuara në marrëveshjen origjinale. Vështirësitë financiare thelbësore të debitorit, probabiliteti që debitori të falimentojë ose të fillojë një riorganizim financiar, mungesa e aftësisë paguese (mbi 30 ditë), konsiderohen si faktorë të cilët tregojnë zhvlerësimin e të arkëtueshmeve. Shuma e provizionit është diferenca ndërmjet vlerës së mbartur të aktivit

dhe vlerës aktuale e flukseve të ardhshme të skontuara me normën efektive origjinale të interesit. Vlera e mbartur e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie reserve dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Kur e arkëtueshmja bëhet e pambledhshme, ajo ç'regjistrohet nga llogaria e rezervës së krijuar. Rimarrja e shumave të ç'regjistruara paraprakisht bëhet duke kredituar pasqyrën e të ardhurave.

Për qëllim të një vlerësimi të përbashkët të rënies në vlerë, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të kreditit (për shembull; në bazë të procesit të gradimit të kompanisë i cili merr në konsideratë llojin e aktiveve, industrinë, vendndodhjen gjeografike, statusin e shkuar dhe të tjerë faktorë të rëndësishëm). Këto karakteristika janë të rëndësishme për matjen e flukseve të ardhshme për këto grupe aktivesh duke qënë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat sipas termave të përcaktuara në kontratën e aktivit që po vlerësohet.

Flukset e ardhshme të parasë të një grupi aktivesh financiare që vlerësohen bashkarisht në lidhje me zhvlerësimin maten në bazë të flukseve të kontraktuara të aktiveve të kompanisë dhe të eksperiencës së shkuar në humbjet që vijnë nga aktivet financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë me aktivet që ka Kompania.

Eksperiencia e kaluar e humbjeve rregullohet me të dhënat e vëzhgimeve aktuale për të reflektuar efektin e kushteve aktuale të cilat nuk kane patur ndikim ne periudhen në të cilën bazohet eksperiencia e humbjeve të kaluara si dhe për të eliminuar efektet e periudhave të kaluara të cilat nuk ekzistojnë në periudhën aktuale.

2.10 Çregjistrimi

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur Kompania humbet kontrollin mbi të drejtat kontraktuale të cilat lidhen me atë aktiv. Kjo ndodh kur të drejtat realizohen, skadojnë ose janë dorëzuar. Një detyrim financiar çregjistrohet kur ai detyrim nuk ekziston më.



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.11 Mjete Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë paratë në dorë, depozitat rrjedhëse në bankë dhe të tjera depozita afat-shkurtra me afat maturimi më pak ose deri në 3 muaj. Lëvizjet e flukseve monetare dhe ekuivalentëve me to tregohen në Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare (Cash- Flow) duke përdorur metodën indirekte.

2.12 Huamarrjet

Huatë njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë neto duke përfshirë kostot e ndodhura të transaksionit. Ato më pas pasqyrohen me koston e amortizuar; çdo diferencë ndërmjet shumës (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shpengimit njihet në pasqyrën e të ardhurave përgjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë klasifikohen si detyrime korente (afat-shkurtra) përveç rastit kur Kompania ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë marrëveshjen e detyrimit për një periudhë prej të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

2.13 Shpenzime për interesa

Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e huave të marra. Diferencat ndërmjet vlerës nominale dhe shumave neto nga kostot e transaksionit të marra njihet në pasqyrën e të ardhurave përgjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.14 Tatimi mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i tatimit mbi fitimin duke ju referuar ligjeve dhe rregullave të Republikës së Shqipërisë. Norma e parashikuar në legjislacionin shqiptar në vitin 2012 ishte 10% (2011: 10%).

Shpenzimet e taksave përfshijnë taksat aktuale dhe të shtyra. Taksat aktuale përbëjnë tatimet e pritshme të pagueshme mbi të ardhurat vjetore të tatueshme duke përdorur normat në fuqi në datën e bilancit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e kaluara.

Tatimi i shtyre mbi të ardhurat është përfshirë plotësisht duke përdorur metodën e detyrimeve në bilanc, mbi diferencat e përkoheshme ndërmjet bazes së tatueshme të aktiveve dhe detyrimeve dhe shumave të tyre të mbartura në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat është përlogaritur duke përdorur normat e taksave (sipas ligjit) të cilat kanë qenë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël dhe që parashikohet të aplikohen kur aktivi i lidhur me tatimin e shtyrë është realizuar ose kur detyrimi i lidhur me tatimin e shtyrë ka lindur.

Të drejtat taimore të shtyra njihen deri në atë masë që është e mundur që përfitime të ardhshme taimore do jenë të vlefshme të cilat mund mbulohen me diferencat e përkohshme.

2.15 Përfitimet e punonjësve

(a) Detyrimet e pensioneve dhe përfitimet pas shkëputjes nga puna:



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

Në rrjedhën normale të biznesit nepermjet reduktimit të pagës mujore, kompania bën derdhje në fondet e detyrueshme të pensioneve në emër të punonjesve të saj në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Të gjitha kontributet e bëra në fondet e detyrueshme të pensioneve pasqyrohen së bashku me shpenzimet e pages bruto në kohën kur ato ndodhin. Kompania bën pagesa në fond në emër të punonjesve të saj duke reduktuar një pjesë të pagës së tyre bruto. Kompania nuk ka ndonjë skemë tjetër pensioni dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë detyrim tjetër në lidhje me pensionet e punonjesve. Gjithashtu, Kompania nuk është e detyruar të ofrojë ndonjë përfitim tjetër pas shkëputjes nga puna.

(b) Përfitimet afat-shkurtra për punonjësit

Kompania krijon një provizion për bonuset kur parashikohen në kontratë apo kur praktika e shkuar krijon një detyrim të tillë. Për më tepër, Kompania njeh detyrimin për mungesat e akumuluar bazuar në ditët pushim të papërdorura deri në datën e raportimi.

2.16 Provizionet

Provizionet njihen kur: Kompania ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv si rezultat të ngjarjeve të shkuara; është shumë e mundshme përdorimi i burimeve për të mbuluar detyrimet e lindura, si dhe shuma e detyrimit është e matshme në mënyrë të besueshme.

2.17 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas janë matur me koston e amortizuar.

2.18 Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative janë njohur në bazë rrjedhëse kur ato kanë ndodhur.

2.19 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të marrë ose për t'u marrë për aktivet e dhëna me qira në rrjedhën normale të biznesit. Të ardhurat janë pasqyruar neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Kompania njeh të ardhurat kur shuma e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike do të hyjnë në kompani dhe janë respektuar kriteret e kompanisë për secilin aktivitet siç është përshkruar më poshtë.

Të ardhurat nga qiraja financiare njihen në bazë të kushteve të qirasë duke përdorur metodën e investimit neto, e cila reflekton një normë konstante kthimi mbi investimin neto të qiradhenësit.

Të ardhurat nga qiraja financiare përfitohen në avancë në bazë mujore dhe pjesa mujore e këtyre ripagesave e cila lidhet me periudhën aktuale shtyhet. Të ardhurat nga komisionet ju referohen tarifave të paguara Kompanisë nga kompanitë e sigurimit për politikën e sigurimit të rëna dakord me ta dhe njihen me bazë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen në një bazë kohore duke përdorur metodën e interesit efektiv.



SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.20 Krahasueshmëria dhe riklasifikimet

Informacioni krahasues është paraqitur në mënyrë konsistente duke aplikuar politikat kontabël të Kompanisë.

Riparaqitja në vijim ka të bëjë me çregjistrimin e qirave financiare të arkëtueshme si pasojë e parregullsive të identifikuara gjatë vitit 2012 të cilat ekzistonin më 31 dhjetor 2011. Në përputhje me kërkesat e SNK 8.5, keqinterpretimi i fakteve konsiderohet ngjarje që kërkon riparaqitje prapavepruese.

a)

PASQYRA E TË ARDHURA DHE SHPENZIME

(të gjitha shumat janë paraqitur në LEK)

	31 dhjetor	
	2011	2011 riparaqitur
Të ardhurat nga interesat	174,918,469	174,918,468
Shpenzime për interesa	(79,581,566)	(79,581,566)
Të ardhura neto nga interesat	95,336,903	95,336,903
Të ardhurat neto nga komisionet	7,306,107	7,306,107
Fitimi bruto nga aktiviteti	102,643,010	102,643,010
Shpenzime administrative	(27,630,838)	(27,630,838)
Shpenzime për punonjësit	(26,866,319)	(26,866,319)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(2,391,443)	(2,391,443)
Shpenzime operative	(56,888,600)	(56,888,600)
Të ardhura / (shpenzime) financiare të tjera	816,976 (16,301,415)	(15,484,439)
Zhvlerësimi i qirave financiare	(8,501,688)	(8,501,688)
Zhvlerësimi i qirave financiare	275,936	275,936
Fitimi (humbja) para tatimit	38,346,420 (16,301,415)	22,045,005
Tatimi mbi fitimin/ (humbjen)	(5,578,290) 1,647,613	(3,930,677)
Fitimi i vitit	32,768,130 (14,653,802)	18,114,328



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më 31 Dhjetor 2012

SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.20 Krahاسimi dhe riklasifikimet (vazhdim)

b)

Bilanci (të gjitha shumat janë shprehur në Lek)	31 dhjetor	
	2011	2011 riparaqitur
AKTIVET		
Mjete monetare	57,797,676	57,797,676
Qira financiare e arkëtueshme	1,514,435,887	(16,301,415) 1,498,134,472
Të arkëtueshme nga furnitorë dhe klientë	13,179,383	13,179,383
Aktive afatgjata jo materiale	6,235,553	6,235,553
Aktive afatgjata materiale	5,093,998	5,093,998
Të drejta tatimore të shtyra	511,478	1,647,613 2,159,091
Aktiva të tjera	190,092,240	190,092,240
TOTALI I AKTIVEVE	1,787,346,215	(14,653,802) 1,772,692,413
DETYRIMET		
Kredi bankare dhe hua të tjera	1,427,825,911	1,427,825,911
Detyrime ndaj furnitorëve dhe klientëve	34,234,562	34,234,562
Detyrim tatimor i shtyrë	-	-
Detyrime të tjera	1,957,365	1,957,365
Totali i detyrimeve	1,464,017,838	1,464,017,838
KAPITALI		
Kapitali aksioner	239,838,000	239,838,000
Primi i aksioneve	62,019,320	62,019,320
Humbja e akumuluar	(11,297,073)	(11,297,073)
Fitimi (humbja) për vitin	32,768,130	(14,653,802) 18,114,328
Totali i Kapitalit dhe Rezervat	323,328,377	(14,653,802) 308,674,575
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	1,787,346,215	(14,653,802) 1,772,692,413



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më 31 Dhjetor 2012

SHËNIMI 2 – PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.20 Krahasimi dhe riklasifikimet (vazhdim)

c)

	31 dhjetor	
(të gjithë shumat janë në LEK)	2011	2011 riparaqitur
Flukset e parash nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	38,346,421	(16,301,415) 22,045,006
Rregullime për:		
Rritje në zhvlerësimin e qirasë financiare	10,632,665	10,632,665
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	2,391,465	2,391,465
Çrregjistrim i qirave financiare të arkëtueshme	-	16,301,415 16,301,415
Shpenzime për interesa	79,582,929	79,582,929
Të ardhura nga interesat	(172,521,726)	(172,521,726)
Ndryshime nga kursi i kembimit	(275,986)	(275,986)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative	(59,699,347)	(41,844,232)
Rritje në qiranë financiare të arkëtueshme	(419,928,953)	(419,928,953)
Rritje në të arkëtueshme nga klientë dhe furnitorë	7,206,964	7,206,964
Rritje në aktive të tjera	(62,749,638)	(62,749,638)
Rritje në detyrime nga klientë dhe furnitorë	11,539,506	11,539,506
Rritja në detyrime të tjera	246,198	246,198
Paraja e përdorur për aktivitetet operative	(463,659,923)	(463,659,923)
Interes i arkëtuar	153,840,847	153,840,847
Interes i paguar	(71,130,039)	(71,130,039)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	(2,272,185)	(2,272,185)
Paraja neto e përdorur për aktivitetet operative	(425,065,532)	(425,065,532)
Flukset e parash në aktivitetet e investimit		
Shitje e aktiveve materiale	-	-
Blerje e aktiveve materiale dhe jo materiale	(1,324,836)	(1,324,836)
Paraja neto e përdorur për aktivitetet e investimit	(1,324,836)	(1,324,836)
Flukset e parave nga aktivitetet e financimit		
Kredi bankare dhe hua të tjera të marra (paguara)	647,645,179	647,645,179
Nënshkrimi i aksioneve të reja	(302,324,878)	(302,324,878)
Fluksi neto i gjeneruar nga aktivitetet e financimit	345,320,301	345,320,301
Rënia e mjeteve monetare	(81,070,117)	(81,070,117)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	138,677,793	138,677,793
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	57,797,676	57,797,676



SHËNIMI 3 – MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shënimi 3 i pasqyrave financiare nuk është përfshirë në këtë version të pasqyrave financiare duke qenë se nuk është i nevojshëm për raportim fiskal.

SHËNIMI 4 – GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME KONTABËL TË RËNDËSISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare të shoqërisë kërkon gjykime të bëra nga ana e menaxhimit, vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe pasiveve, si dhe shfaqjen e detyrimeve të kushtëzuara, në datën e raportimit. Megjithatë, pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultatet që kërkojnë një rregullim material në vlerën kontabël të aktivit ose pasivit të ndikuar në periudhat e ardhshme.

Supozimet kryesore lidhur me burimet e ardhshme dhe burime të tjera kyçe të pasigurisë në matje në datën e bilancit, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë të shënuara më poshtë.

(a) Humbjet nga zhvlerësimi i qirase financiare dhe llogarive të arkëtueshme

Kompania teston rregullisht qirate financiare të arkëtueshme për zhvlerësim. Gjate këtyre testimeve, Kompania merr parasysh pagesat e rregullta të bëra nga qiramarresi, psh. Debitori, pozicionin financiar dhe operacional, arkëtueshmerinë e pagesave të instrumentave sigurues, planin e biznesit, mjedisin e biznesit dhe kushtet lokale ekonomike si dhe një sërë kriteresh të tjera në mënyrë që të bëjë vlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Drejtimi konsideron qirane financiare të mbuluar me kolateral si të zhvlerësuar sepse eksperiencia ka treguar që një pjesë e rëndësishme e kolateralit të qirase financiare nuk mund të ushtrohet për arsye administrative dhe ligjore. Provizioni reflekton probabilitetin që drejtimi nuk do mundet të ushtrojë të drejtën e posesimit të kolateralit në rast se qiraja nuk paguhet. Pavarësisht vështirësive të rimarrjes së kolateralit, drejtimi i Kompanisë do përpiqet në mënyrë rigoroze në rimarrjen e kredive të keqja. Nëse vlera neto e fluksit të parave të parashikuar ndryshon me +/-5%, provizioni parashikohet të jetë përafërsisht EUR 9,749 (1.4 mln lek) më shumë / më pak (2011: 4,250 më shumë/ më pak).

(b) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë. Kompania financon 26% të aktiveve me fonde të saja, kurse 74% të aktiveve financohen me fonde të jashtme, kryesisht me kreditë nga EELF, DEG, FMO, EBRD dhe bankat lokale (Nota 20). Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën supozimin se palet e lidhura do të mundësojnë mjaftueshëm fonde financiare, nën kushte normale, që do të mundësojnë veprimtarinë e Kompanisë në të ardhmen.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Duke patur parasysh faktin që një pjesë e huave të Kompanisë më 31 dhjetor 2012, mund të ishin të pagueshme në të parë kundrejt huadhënësit përkatës në vijim të shkeljes së njërit prej kriterëve (siç është përshkruar në shënimin 20). Kompania pas disa negociatash, ka marrë një dokument çlirues nga huadhënësi më 1 korrik 2013, që mbulon periudhën shtator 2012 – shtator 2013. Rrjedhimisht, drejtuesit kanë një pritshmëri të arsyeshme që Kompania zotëron burimet e nevojshme për të vijuar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Në këtë mënyrë është e përshtatshme përgatitja e pasqyrave në bazë të parimit të vijimësisë. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të ishin rezultat i pamundësisë së Kompanisë për të kryer veprimtarinë e saj në vijimësi.



SHËNIMI 4 – GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)*(c) Përzgjedhja e monedhës funksionale*

Zerat ne pasqyrat financiare te kompanise vleresohen duke perdorur monedhen primare te ambientit ekonomik ne te cilen Kompania ushtron veprimtarine e saj – Leku Shqiptar (LEK), qe është monedha funksionale. Pavaresisht faktit qe shume aktive dhe passive jane te nominuara ne monedhen EUR, drejtimi beson qe keto aktive dhe pasive permbajne norma interesi qe reflektojne riskun qe i perket Shqiperise. Si vazhdim, shpenzimet operacionale te Kompanise behen ne monedhen Lek dhe reflektojne realitetin e tregut shqiptar.

(d) Ndryshimet ne tregun financiar global

Kriza financiare globale ka rezultuar ne nje nivel te ulet te tregut te fondeve kapitale, nivele te uleta likuiditeti ne sektorin banker, dhe , here pas here, ne norma te larta interesi ne kreditë nderbankare. Perhapja e krizes financiare e ben te pamundur parashikimin ose mbrojtjen totale ndaj saj.

Volumi i financimit nga tregu primar është ulur ndjeshem. Keto rrethana ndikojne ne aftesine e Kompanise per te perfutur nje kredi te re ose rifinancim te kredive ekzistues ne terma dhe kushte te ngjshme me ato te aplikuara ne transaksionet e meparshme.

Klientet e Kompanise mund te ndikohen nga likuiditeti i ulet i cili do te ndikonte ne aftesite e tyre per te kryer pagesat. Perkeqesimi i kushteve operacionale per klientet mund te këtë ndikim ne parashikimin e fluksit monetar te kompanise dhe parashikimin e provizionit te aktiveve financiare dhe jo financiare. Drejtimi ka reflektuar ne parashikimet e fluksit te parase dhe ne provizion, informacionin e lartpermendur, ne masen qe është e mundshme. Aftesia e klienteve per kryerjen e pagesave ndaj Kompanise nuk është ndikuar ne menyra sinjifikative nga kriza financiare ne Shqiperi.

SHËNIMI 5 – TË ARDHURA NGA INTERESI

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	(ne LEK)	
Qiraja financiare	196,199,019	162,514,927
Qiraja financiare nga klientet e vonuar	16,812,639	10,006,798
Të ardhura nga komisione për mbyllje të parakohshme	<u>3,878,454</u>	<u>-</u>
Totali	<u>216,890,112</u>	<u>172,521,726</u>

Një shpjegim për qiranë financiare është dhënë në shënimin 14.

SHËNIMI 6 – SHPENZIME TË INTERESIT

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	(ne LEK)	
Shpenzime interesi nga huatë	<u>(96,585,276)</u>	<u>(79,582,929)</u>
Totali	<u>(96,585,276)</u>	<u>(79,582,929)</u>

